

## Raporti i Auditorit të Pavarur

### Për aksionarët dhe menaxhmentin e Scardian J.S.C.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkangjitura të KS "Scardian" J.S.C., ("Kompania"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015 dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimit të kapitalit dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2015 si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

### *Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat e veçanta Financiare*

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Menaxhmenti, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

### *Përgjegjësia e Auditorit*

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që të jemi në përputhje me kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumatat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistimit të gabimeve materiale në pasqyrat financiare, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm të rëndësishëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të projektojë procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme në rrethana të caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Menaxhmenti, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

### *Opinionit*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të bashkangjitura paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të KS Scardian J.S.C. me 31 dhjetor 2015, si dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur më këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Prishtinë, Kosovë

31 mars 2016


Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see <http://www.deloitte.com/about> for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.


Member of Deloitte Touche Tohmatsu Limited

**KS "SCARDIAN" J.S.C**  
**Pasqyra e pozicionit financiar**  
**(shumat në Euro)**

<b>Asetet</b>	<b>Shënime</b>	<b>Më 31 dhjetor 2015 EUR</b>	<b>Më 31 dhjetor 2014 EUR</b>
<b>Asetet afatshkurta</b>			
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	6	858,976	3,580,404
Depozitat e afatizuara	7	3,800,007	900,000
Llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi	8	34,750	-
Kostot e shtyera te blerjes	9	366,101	-
Asete tjera financiare	10	125,000	-
Parapagimet dhe asetet tjera	11	184,262	174,116
<b>Gjithsej asetet afatshkurta</b>		<b>5,369,096</b>	<b>4,654,520</b>
<b>Asetet afatgjata</b>			
Prona dhe pajisjet	12	525,089	172,806
Asetet e paprekshme	13	29,910	-
<b>Gjithsej asetet afatgjata</b>		<b>554,999</b>	<b>172,806</b>
<b>Gjithsej asetet</b>		<b>5,924,095</b>	<b>4,827,326</b>
<b>Kapitali dhe detyrimet</b>			
<b>Detyrimet afatshkurta</b>			
Rezerva për dëmet ne proces	14	412,535	-
Rezervat e primit të pafiturar	15	1,401,745	-
Detyrime tjera	16	263,001	18,300
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurta</b>		<b>2,077,281</b>	<b>18,300</b>
<b>Ekuiteti</b>			
Kapitali aksionar		5,000,000	4,999,000
Humbjet e akumuluar		(189,974)	-
Humbjet e vitit aktual		(963,212)	(189,974)
<b>Gjithsej ekuiteti</b>		<b>3,846,814</b>	<b>4,809,026</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>5,924,095</b>	<b>4,827,326</b>

Autorizuar për publikim nga menaxhmenti i kompanisë më 31 mars 2016:

  
**Blerim Pushkolli**  
 Drejtor Ekzekutiv

  
**Tenta Rexhbeçaj**  
 Drejtor Financiar

Shënimet shoqëruese në faqet 8 deri në 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.